

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- kolegj i përbërë nga gjyqtarë Nesrin Lushta kryetare, Valdete Daka dhe Agim Maliqi anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini – Simnica, procesmbajtëse, në çështje penale të dënuarit N.K. nga fshati D.eE., komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, av. R.K., ushtruar aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.39/2017 datë 24.4.2017, dhe aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.262/2017 datë 22.9.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 6.3.2018, morri këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë së mbrojtësit të të dënuarit N.K., ushtruar kundër aktgjykimin të Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.39/2017 datë 24.4.2017 dhe aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr. 262/2017 datë 22.9.2017.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.39/2017 datë 24.4.2017, i dënuari N.K., është shpallur fajtor për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.2 të KPK, dhe është gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e (gjashtë) muajve si dhe me dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) € ndërsa në dënimin e shqiptuar i është llogaritur edhe koha kaluar në paraburgim prej datës 28.1.2017 deri më 24.4.2017. I dënuari është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100 € e në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimin.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit të Kosovës me aktgjykimin PAKR.nr.262/2017 e datës 22.9.2017, pjesërisht ka aprovuar ankesën e mbrojtësi të të dënuarit dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkritazi me vendimin mbi dënimin ashtu që të dënuarit N.K. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tri) vite në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej

28.1.2017 deri më 24.4.2017, dhe me dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) €, ndërsa pjesa tjetër e aktgjykimit ka mbetur e pa ndryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit av. R.K. nga Prishtina për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga nenin 384 par.1 nën par 1.8 dhe 1.12 lidhur me nenin 370 par.4,6,7,8 dhe 9 neni 262 par.4 të KPPK, si dhe nenit 384 par.2 nënpar.2.1 të KPPK, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Prokurori i Shteti me parashtresën KMLP.II.nr.206/2017 datë 8.11.2017, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit N.K.

Gjykata Supreme në seancën e kolegjit pas shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit, av. R.K. pretendon se aktgjykimet e të dy gjykatave janë përfshi me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale meqenëse aktgjykimi i shkallës së parë nuk i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme ashtu si është përcaktuar me dispozitën e nenit 370 të KPPK, e kjo nga fakti se edhe atëherë kur pranohet fajësia nga i dënuari ai duhet ta dinë për çka është dënuar dhe si është dënuar. Mbrojtja pretendon se edhe pse i dënuari në shqyrtimin fillestar ka pranuar fajësinë megjithatë i njëjti nuk është udhëzuar komfor nenin 246 të KPPK, sepse në fakt në procesverbal të shqyrtimit të datës 24.4.2017, vetëm konstatohet fakti se ai është udhëzuar dhe i njëjti pasi që i është dhënë mundësia që të kontaktoj me mbrojtësin e tij është sqaruar rreth pranimi apo mos pranimi të fajësisë pra as kund nuk ka deklarim shprehimor të të dënuarit lidhur me pranimin e fajësisë. Ndërkaq këto shkelje të cekura Gjykata e Apelit nuk i ka vërejtur dhe i ka pranuar si të tilla. Po ashtu pretendohet se të dënuarit nuk i është dhënë mundësia që ta jep fjalën e fundit dhe nëse pajtohet me mbrojtjen e prezantuar nga mbrojtësi i tij.

Sa i përket shkeljeve të ligjit penal në dëm të të dënuarit në kërkesë pretendohet se me faktin se aktgjykimet janë të përfshira me shkeljet e cekura më sipër ndaj të dënuarit është shkel edhe ligji penal kur është shpallur fajtor për veprën penale për të cilën edhe është gjykuar.

Gjykata Supreme duke vlerësuar pretendimet si dhe nga shkresat e çështjes ka vërtetuar se i dënuari në shqyrtimin fillestar të datës 24.4.2017, ka prezantuar në shqyrtim së bashku me mbrojtësin e tij avokatit E.G., nga Prizreni, dhe para se ti lexohet aktakuza është udhëzuar komfor dispozitës së nenit 246 të KPPK, pra është njoftuar me pasojat e pranimi dhe mos pranimi të fajësisë. Pas kësaj i është lexuar aktakuza dhe i është dhënë mundësia që të kontaktoi me mbrojtësin e tij në sallën e veçantë për kontakte. I dënuari pasi që është konsultuar me mbrojtësin e tij është deklaruar rreth pranimi të fajësisë për veprën penale sipas aktakuzës, ndërsa gjykata ka pranuar me aktvendim këtë pranim të fajësisë i cili është bërë komfor nenit 248 të KPPK. Pra pasi që i dënuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, pranimi

është bërë në bazë vullnetare pas konsultimit me mbrojtësin e tij dhe ky pranim mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza e cila nuk ka as një shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Pas kësaj është vazhduar me fjalën përfundimtare ku i dënuari deklaroi se pajtohet me pohimet e mbrojtësit e tij, pendohet për veprën e kryer, thekson se kjo është hera e parë që ka rënë në konflikt me ligjin dhe se tash e tutje nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme.

Të gjitha këto gjenden të konstatuara në procesverbalin e shqyrtimit fillestar të datës 24.4.2017, çka dëshmon se i dënuari ka qenë i njoftuar sipas dispozitave të nenit 246 të KPPK, se pranimi është bërë komfor nenit 248 të KPPK dhe se për këtë është deklaruar andaj, asnjë nga pretendimet e mbrojtësit nuk qëndrojnë.

Në këtë situatë, drejt është zbatuar ligji penal kur i dënuari është shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është gjykuar.

Meqenëse aktgjykimet nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe nuk është shkelur ligji penal në dëm të të dënuarit kjo Gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e duke u bazuar në nenin 437 të KPPK.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Pml.nr.300/2017, më 6 mars 2018

Procesmbajtëse,  
Mirlinda Mejzini- Simnica

Kryetare e kolegjit,  
Nesrin Lushta